



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 120, Datë 06.05.2026

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “PROSOL” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 705/10 prot., datë 05.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PROSOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609 prot., datë 10.10.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 259, datë 21.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.10.2025 dhe 23.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.11.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2609/3 prot., datë 27.10.2025, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.
- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë dhe duke qenë se ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet, bordi i ERE-s me vendimin nr. 339, datë 23.12.2025, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së kërkesës së shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali

- fotovoltaik. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 2609/15 prot., datë 29.12.2025.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 142 prot., datë 13.01.2026, shoqëria ka njoftuar se ende nuk e disponon dokumentacionin, ndaj bordi i ERE-s, me vendimin nr. 16, datë 26.01.2026, vendosi të pezullojë afatin e vendimmarrjes lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim, deri në depozitimin nga ana e shoqërisë të këtij dokumentacioni.
 - ERE, me shkresën nr. 142/2 prot., datë 02.02.2026, ka njoftuar shoqërinë dhe ka vënë në dijeni MIE-n, për vendimmarrjen e sipërcituar.
 - MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1724 prot., datë 18.02.2026, është shprehur se referuar Kontratës nr. 1353 rep., nr. 578 kol., datë 18.03.2025, kapaciteti i instaluar i centralit është 21 MW.
 - Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë dhe seancës dëgjimore, të mbajtur në ERE më datë 17.03.2026, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 705/4 prot., datë 18.03.2026, shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së bordit, me qëllim depozitimin të dokumentacionit të përditësuar.
 - Për sa më sipër, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 02.04.2026, vendosi të heqë pezullimin e vendosur me vendimin nr. 16 datë 26.01.2026 dhe të zgjasë afatin e vendimmarrjes përfundimtare për aplikimin e shoqërisë me 30 ditë.
 - Ky vendim iu njoftua shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 705/8 prot., datë 08.04.2026.
 - Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 705/9 prot., datë 24.04.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues.
 - Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të Aneksit A të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 92, datë 12.02.2025 është miratuar ndërtimi i centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 21 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “PROSOL” sh.p.k.
- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n Kontratën nr. 1353 rep., nr. 578 kol., datë 18.03.2025 “*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 21 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “PROSOL” sh.p.k.*”.
- Shoqëria ka nënshkruar me OST sh.a. “*Marrëveshjen për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të Parkut Fotovoltaik Prosol Solar*”, protokolluar në OST sh.a. me nr. 2408/4 prot., datë 26.06.2025.

- Shoqëria është pajisur me VNM Paraprake nr. AN280820240010, datë 19.07.2024, Komisioni 118, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për Personin Juridik “PROSOL” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “Ndërtimi i Centralit Fotovoltaik Prosol Solar, 21 MW”.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Jetëgjatësia e paneleve që shoqëria parashikon të përdorë është 30 vjet, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.
- Rezulton se shoqëria ka siguruar mjetet financiare për të financuar realizimin e projektit sipas modalitetit të financimit 80% me kredi bankare dhe 20% me financim nga kapitali aksionar, por në planin e biznesit të përditësuar ka parashikuar mundësinë e financimit të realizimit të projektit 100% me kredi bankare, ndaj vlerësohet që shoqëria përpara fillimit të operimit, të depozitojë në ERE dokumentacionin përfundimtar të përditësuar për financimin e projektit.
- Shoqëria është pajisur me miratimin nga OST sh.a. për kapacitetin e instaluar 21 MWp nëpërmjet “Marrëveshjes për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të Parkut Fotovoltaik Prosol Solar”, protokolluar në OST sh.a. me nr. 2408/4 prot., datë 26.06.2025. Në vijim, duke qenë se në dokumentacionin e depozituar gjatë shqyrtimit të aplikimit janë evidentuar paqartësi lidhur me saktësimin e kapacitetit të instaluar të centralit (21 MW/21 MWp), shoqëria ka paraqitur pranë OST sh.a. kërkesën për marrjen e një konfirmimi/qëndrimi të shprehur lidhur me fuqinë e instaluar të projektit.. Në rrethanat kur e drejta e aksesit në rrjetin elektrik është e garantuar dhe rezulton se shoqëria ka një miratim nga OST sh.a., vlerësohet që t’i lihet kusht që, përpara fillimit të operimit, të depozitojë në ERE miratimin/qëndrimin e OST sh.a.
- Shoqëria aktualisht disponon një VNM Paraprake nr. AN280820240010, datë 19.07.2024, të vlefshme deri më 19.07.2026, ndaj vlerësohet që t’i lihet asaj kusht që të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve brenda kësaj date, përndryshe duhet të depozitojë një VNM Paraprake të re.
- Shoqëria ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda datës 01.03.2027 (brenda afatit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar me MIE-n). Në këto rrethana, vlerësohet që të përcaktohet që ajo duhet të fillojë operimin brenda kësaj date.
- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që t’i lihet detyrë shoqërisë që, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës. Brenda këtij afati vlerësohet që t’i lihet asaj detyrë që të përditësojë në ERE dhe informacionin përkatës për strukturën organizative.
- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “PROSOL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin/qëndrimin e OST sh.a. në lidhje me saktësimin e fuqisë së instaluar 21 MW të centralit, si dhe dokumentacionin përfundimtar të përditësuar për financimin e projektit.
3. Shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e ndërtimit brenda afatit të vlefshmërisë së VNM Paraprake aktuale, pra brenda datës 19.07.2026, përndryshe duhet të depozitojë në ERE një VNM të re.
4. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 01.03.2027.
5. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.
6. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3, 4 dhe 5, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “PROSOL” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a., dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI